

IA dhe e ardhmja e gazetarisë

Një dokument informues për aktorët e interesuar

Dr. Anya Schiffrin, Columbia University

MESAZHET KRYESORE:

- Organizatat e gazetarisë po e përqafojnë IA-në gjenerative si pjesë të praktikës së redaksive, por janë të kujdesshme ndaj ndikimit ekonomik të kompanive të mëdha që përfitojnë nga përmbajtja e tyre, nëse ajo përdoret pa lejen dhe kompensimin e duhur.
- Media anembanë botës ka publikuar kode sjelljeje që theksojnë respektimin e të dhënave të audiencës, autenticitetin e përmbajtjes, vetëdeklarimin kur përdoret IA, transparencën, diversitetin dhe integritetin e informacionit, si dhe të drejtën për shpërblim nga firmat e IA-së.
- Pa marrëveshje për të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale, modeli aktual i biznesit të krijimtarisë gazetareske do të dëmtohet rëndë dhe, bashkë me të, lind një kërcënim serioz për diversitetin kulturor. Vetë modelet do të jenë të pabesueshme nëse nuk trajtohen me informacion cilësor.
- Krahës ndikimit nga rritja e IA-së gjenerative, organizatat e lajmeve dhe gazetarët po e mbulojnë këtë temë dhe po i edukojnë audiencat rreth rreziqeve dhe përfitimeve të mundshme.
- Përqendrimi në sektorin e IA-së do të ketë pasoja të thella për mbarë botën dhe autoritetet e konkurrencës po vlerësojnë nëse nevojiten rregullore të reja.
- Krijuesit, botuesit dhe gazetarët kanë insistuar për përditësimin e rregulloreve të së drejtës së autorit, ose të paktën zbatimin rigoroz të atyre ekzistuese, duke siguruar që ato të marrin parasysh teknologjitë e reja.
- Disa organizata gazetarie po nënshkruajnë marrëveshje licencimi me firmat e mëdha të IA-së gjenerative. Duke vepruar kështu, këto organizata po insistojnë në kërkesën për kompensim dhe po krijojnë një treg për licencimin e përmbajtjes.
- Fushat kryesore për t'u marrë në konsideratë përfshijnë: ruajtjen e autenticitetit, diversitetin e gjuhëve dhe të kulturave dhe transparencën e informacionit. Ruajtja e tregjeve konkurruese mund të ndihmojë në shmangien e përkeqësimit të mëtejshëm të ekosistemit kulturor dhe informativ.

I. Gazetarët po e përqafojnë me kujdes IA-në gjenerative

Zhvillimet në inteligjencën artificiale (IA) dhe IA-në gjenerative ndryshojnë vazhdimisht. Qeveritë, sektori i arsimit dhe publiku e kanë të vështirë të mbajnë këtë ritëm të shpejtë. Hartimi i politikave që nuk vjetrohen duket pothuajse i pamundur. IA gjenerative mund ta transformojë (madje edhe ta shkatërrojë) gazetarinë siç e njohim, prandaj komuniteti gazetaresk është përqendruar në shumë aspekte të kësaj dukurie.

IA gjenerative

IA gjenerative u referohet sistemeve të inteligjencës artificiale të afta për të gjeneruar përmbajtje si tekst, tinguj, imazhe dhe kod, bazuar në të dhëna hyrëse (*input data*). Këto sisteme përdorin algoritme për të prodhuar mostra të reja të dhënash që imitojnë modelet dhe strukturat e të dhënave hyrëse mbi të cilat janë trajnuar. Shembuj aktualë të mjeteve të IA-së gjenerative janë ChatGPT dhe Midjourney.

Burimi: UNESCO

- Shumë redaksi e kanë përqafuar IA-në gjenerative si mjet raportimi. IA gjenerative përdoret për analizimin e të dhënave dhe punën me vëllime të mëdha materialesh, ndërsa teknikat përkatëse po mësohen në shumë shkolla gazetarie dhe në seminare anembanë botës. UNESCO ka publikuar një manual mbi raportimin për inteligjencën artificiale (“Reporting on Artificial Intelligence”).
- Shoqatat e gazetarëve dhe redaksitë kanë publikuar parime udhëzuese, kode sjelljeje dhe karta të shumta lidhur me përdorimin e IA-së gjenerative. Këto theksojnë rëndësinë që mediat të vetëdeklarojnë kur kanë përdorur IA gjenerative për të krijuar tekste ose materiale audio/vizuale që u shfaqen audiencave.
- Saktësia dhe besueshmëria janë parësore për mediat cilësore dhe shqetësimet për “halucinacionet” e rezultateve të IA-së gjenerative janë në qendër të vëmendjes. Përfshirja dhe mbikëqyrja njerëzore janë thelbësore sa herë që përdoret IA gjenerative, për të parandaluar përhapjen e informacionit të pasaktë ose çorientues. UNESCO ka vënë në dukje gjithashtu rreziqet e “mbithjeshtëzimit”, pra të theksimit të një pike relativisht të parëndësishme në vend të idesë kryesore.
- Gazetarët luajnë rol kyç në edukimin e publikut rreth IA-së gjenerative dhe në ndërgjegjësimin për disa prej rreziqeve. Rreziqet e *deepfake*-ve janë diskutuar gjerësisht në komunitetin gazetaresk, veçanërisht në vitin 2024, për shkak të rrezikut që ato paraqesin për zgjedhjet dhe demokracinë. Gazetarë nga e gjithë bota janë përfshirë thellësisht në lëvizjen për edukimin për median dhe informacionin.
- Rreziqet e *deepfake*-ve përjetohen personalisht nga shumë anëtarë të komunitetit gazetaresk. Përmbajtje të rreme janë krijuar për të diskredituar dhe sulmuar gazetarë të njohur, si fituesja e çmimit Nobel, Maria Ressa, dhe Patricia Campos Mello nga Brazili. Në fakt, raporti i UNESCO-s i vitit 2023 mbi dhunën me bazë gjinore dhe IA-në gjenerative paralajmëron se teknologjia *deepfake* mund ta përkeqësojë problemin e dhunës online ndaj grave.
- Qeveritë dhe studiuesit e kanë të vështirë të parashikojnë efektet e jashtëzakonshme ekonomike dhe pasojat e mundshme mbi punësimin, tregun e punës, arsimin, madje edhe stabilitetin shoqëror, nëse humbet një numër i madh vendesh pune, me pasoja të mëdha për pabarazinë e të ardhurave. E njëjta gjë vlen edhe për botën e gazetarisë, të arsimit dhe të kulturës, ku ka pasiguri se cilat organizata do ta përdorin IA-në gjenerative dhe si. Ajo tashmë përdoret gjerësisht në marketing dhe komunikim dhe, për rrjedhojë, vende pune si: shkrimtarë, reporterë, redaktorë dhe përkthyes janë shkurtuar ose transformuar.
- Efektet zinxhir janë gjithashtu të jashtëzakonshme, pasi kompanitë që zotërojnë modelet e mëdha gjuhësore (*Large Language Models*, LLM) dhe prodhojnë mjetet më gjithëpërfshirëse të IA-së gjenerative mund të përfundojnë si një grup monopolesh, të përqendruara kryesisht në një ose dy

vende. Edhe çështjet e zinxhirit të furnizimit, si aksesit te çipat e nevojshëm për trajnimin dhe funksionimin e modeleve, janë kthyer në çështje urgjente. Këto tema do të bëhen kyçe për rregullatorët dhe qeveritë, si dhe për sektorin privat.

“Ditët kur kishte rëndësi nëse një kompani renditej e treta apo e katërta në faqen e kërkimit të Google kanë marrë fund, sepse agjentët e IA-së do ta skanojnë të gjithë web-in për të nxjerrë rezultate.”

Toshit Panigrahi, bashkëthemelues i firmës së licencimit TollBit, e cila punon me botues për monetizimin e të dhënave të tyre.

- Një temë tjetër e rëndësishme është pagesa për përdorimin e pronësisë intelektuale, përfshirë çështjen e së drejtës së autorit për të dhënat hyrëse në LLM-të. Dështimi për t’i kompensuar në mënyrë të përshtatshme krijuesit e informacionit dhe të dijes, të cilët kanë kohë që shërbejnë për trajnimin e LLM-ve, mund të ketë në vetvete pasoja të mëdha për ekosistemin e informacionit dhe të dijes.
- Përfitimi pa kundërshpërblim (*freeriding*) nga krijimtaria kulturore dhe gazetareske është një kërcënim kyç, pasi do të dëmtojë nxitjet për të prodhuar informacion. Pagesat e drejta për botuesit dhe artistët do të ndihmojnë në mbrojtjen e ekosistemit informativ dhe kulturor. Pa to, përballemi me përqekësimin e modeleve, me pasoja potencialisht të rënda negative.

Fundi i kërkimit? Trafiku i faqeve të internetit mund të shembet, dhe bashkë me të edhe të ardhurat e krijuesve.

Kërkimet e reja të fuqizuara nga IA gjenerative që po zhvillojnë Google, OpenAI dhe të tjerë, mund të shënojnë fundin e trafikut drejt faqeve web. Kjo do të ketë efekt të jashtëzakonshëm për mediat e varura nga trafiku i kërkimit. Nuk do të preket vetëm reklamimi, ku më pak shikues do të thotë më pak të ardhura nga reklamat, por edhe abonimet, pasi lexuesit shpesh abonohen pasi drejtohen në faqen e internetit. Në përgjigje të kësaj, disa botime po punojnë me OpenAI për të siguruar që motorët e ardhshëm të kërkimit të lidhen me përmbajtjen e tyre. Në korrik 2024, revista amerikane The Atlantic njoftoi se po zhvillonte gjithashtu një motor kërkimi dhe një *browser extension*.

Modelet e Mëdha Gjuhësore (LLM)

Modelet e Mëdha Gjuhësore (LLM) janë modele të avancuara të IA-së, të trajnuara me sasi të mëdha të dhënash për të kuptuar dhe gjeneruar tekst të ngjashëm me atë njerëzor. Këto modele, si GPT i OpenAI dhe Llama i META-s, mund të kryejnë detyra të ndryshme gjuhësore, përfshirë përkthimin, përmbledhjen, përgjigjen ndaj pyetjeve e më shumë.

Burimi: UNESCO

Efkti i IA-së gjenerative mbi konkurrencën

Ekziston një debat se sa konkurrues do të jetë biznesi i LLM-ve: disa besojnë se ai do të “komodifikohet”, të paktën për shumicën e përdorimeve, ndërsa të tjerë argumentojnë se do të ketë vetëm pak firma me fitime të mëdha monopoliste. Edhe në rastin e dytë ka shqetësime për fitimet monopoliste në disa pjesë të zinxhirit.

Raporti i vitit 2023, i autoritetit portugez të konkurrencës, paralajmëroi se pothuajse të gjitha aspektet e krijimit të IA-së gjenerative kanë implikime për tregjet konkurruese.

- Aksesit tek të dhënat është kyç, por ato mbahen në mënyrë të shpërpjesëtuar në duart e pak firmave të fuqishme, gjë që u jep atyre avantazh konkurrues, duke ua shtuar fuqinë e madhe në treg.
- Përdorimi i sasive masive të të dhënave që ato kanë në dispozicion mund të bjerë gjithashtu ndesh me GDPR-në dhe me të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Fuqia llogaritëse kërkon qasje në shërbime *cloud* dhe pajisje me kosto të përballueshme, por tregu i *cloud*-it është shumë i përqendruar, me pjesë të konsiderueshme në duart e po atyre firmave që dominojnë të dhënat, duke ofruar kështu një rrugë tjetër për zgjerimin e fuqisë së tregut.
- Njohuritë praktike dhe mundësia për të eksperimentuar janë thelbësore për inovacionin, por mungesa e aksesit në të dhëna, kontratat që i “prangosin” punonjësit dhe i pengojnë të ndërrojnë kompani, si dhe marrëveshjet ndërmjet firmave për mospunësim të ndërsjellë (*no-poach*) janë të gjitha ngërçe që mund ta mbysin konkurrencën.

II. Mbi IA-në gjenerative dhe efektet në krijimin e përmbajtjes

Në nivel makroekonomik, IA përfaqëson një vazhdim të përparimeve të dijes të lidhura me revolucionin dixhital, duke ngritur pyetje se deri në ç’masë ajo do ta *zëvendësojë punën* apo do të *shtojë aftësitë*. Në skenarin e dytë, ajo mund t’i rrisë pagat, ndërsa në të parin thellon pabarazinë. IA ndryshon nga inovacionet e mëparshme (si robotët dhe makineritë), sepse këto makina jo vetëm janë më të fuqishme dhe llogarisin më shpejt, por edhe mund të mësojnë, aftësi që disa e shohin si aftësinë themelore njerëzore. Ato mund të mësojnë më shpejt, të paktën në fusha të caktuara.

Shqetësimi më i madh ka të bëjë me arritjen nga LLM-të të inteligjencës artificiale të përgjithësuar, ku IA ka kapacitete mësimi që shkojnë përtej fushave të mirëpërcaktuara. Ka një larmi të madhe pikëpamjesh nëse dhe kur mund të arrihen kapacitete të tilla. Nuk do ta trajtojmë më tej këtë çështje në këtë dokument; por, nëse do të arrihej kjo pikë (e quajtur në literaturë “singulariteti”), ajo do të ishte transformuese për mbarë shoqërinë tonë.

LLM-të mund të sintetizojnë dhe analizojnë të dhëna nga një numër i madh burimesh, gjë që mund t’i bëjë individët të neglizhojnë konsultimin e burimeve origjinale. Duke iu shtuar vështirësive financiare me të cilat përballen sot mediat (të trajtuara në dokumentin informues të UNESCO-s mbi qëndrueshmërinë e medias, “*Finding the Funds for Journalism to Thrive*”), frika është se, nëse kompanitë e LLM-ve nuk i kompensojnë burimet origjinale, kjo pashmangshmërisht do t’ua pakësojë të ardhurat, duke ua shterur financimin dhe, rrjedhimisht, prodhimin e informacionit origjinal e të vlefshëm. Por gjërat janë edhe më komplekse: cilësia e LLM-ve mund të jetë aq e lartë sa ç’është cilësia e të dhënave mbi të cilat ato trajtohen. Megjithatë, kompanitë e LLM-ve nuk e kanë marrë plotësisht parasysh këtë; problemi bëhet edhe më akut nëse ka shumë LLM, sepse atëherë asnjëra prej tyre nuk do të marrë përgjegjësi për efektet kolektive mbi ekosistemin e informacionit. Ekziston madje rreziku që ato të dëmtojnë modelin e biznesit të motorëve të kërkimit, të cilët vetë e kanë dëmtuar ekosistemin e informacionit cilësor. Prandaj, disa organizata gazetarie po shqyrtojnë tani mundësinë e investimit në motorët e tyre të kërkimit dhe po përpiqen të planifikojnë për ditën kur kërkimi nuk do të sjellë më trafik.

LLM-të potencialisht pasqyrojnë, madje edhe amplifikojnë, paragjykimet dhe shtrembërimet e pranishme në të dhënat ekzistuese mbi të cilat trajnohen. Nëse ato të dhëna pasqyrojnë paragjyime të vjetra racore ose gjinore, këto paragjyime do të pasqyrohen në rezultatet e LLM-ve. Delegimi i vendimmarrjes të IA e dëmton transparencën e proceseve vendimmarrëse, sepse edhe vetë ndërtuesit e këtyre modeleve nuk e dinë plotësisht se si funksionojnë ato.

Të vetëdijshme për këto rreziqe, organizata anembanë botës kanë publikuar si analiza, ashtu dhe rekomandime se si duhet trajtuar IA gjenerative. Shumë prej tyre përqendrohen te parimet e diversitetit kulturor, kujdesit të duhur për të drejtat e njeriut, barazisë dhe sigurisë të integruara që në fazën e dizajnit, transparencës dhe llogaridhënies kur përdoret IA gjenerative. Organizata si Forumi Ekonomik Botëror, Reporterët pa Kufij dhe agjenci të ndryshme të OKB-së kanë ofruar parime udhëzuese dhe karta të rëndësishme.

Për shembull, në nëntor 2021, UNESCO miratoi standardin e parë global mbi etikën e IA-së, të njohur si “Rekomandimi mbi Etikën e Inteligjencës Artificiale”. Rekomandimi u pasua nga publikimi i Udhëzimeve për Qeverisjen e Platformave Dixhitale (nëntor 2023). Së fundi, në vitin 2024, Kombet e Bashkuara botuan Parimet Globale për Integritetin e Informacionit. Të gjitha këto instrumente, të lexuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, hedhin dritë mbi mënyrën se si duhet t'i qasemi qeverisjes së sistemeve të IA-së me një qasje shumëpalëshe të bazuar tek të drejtat e njeriut.

Qasja më e fundit e UNESCO-s ndaj qeverisjes së platformave të përmbajtjes së gjeneruar nga IA erdhi me Udhëzimet për Qeverisjen e Platformave Dixhitale, të cilat përvijojnë qartë rëndësinë e sistemeve të pavarura të qeverisjes, operacionet dhe veprimet e të cilave janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut: janë transparente dhe llogaridhënëse, kanë kontrolle dhe balanca të institucionalizuara, janë të hapura e të aksesueshme dhe promovojnë aktivisht diversitetin kulturor.

Ndërkohë, platformat duhet të tregojnë kujdesin e duhur (*due diligence*), të jenë transparente e llogaridhënëse, t'u ofrojnë përdoruesve mjete për t'u angazhuar dhe vepruar në mënyrë kritike me produktet e tyre dhe t'i ngrenë sistemet e proceset e tyre mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Ndalimi i *deepfake*-ve: roli i autenticitetit dhe i prejardhjes së përmbajtjes

LLM-të janë modele parashikuese: duke pasur një sekuencë fjalësh, ato parashikojnë fjalën e radhës, mbi bazën e sasisë masive të të dhënave me të cilat janë trajnuar. Por në shumë fusha nevojiten të dhëna të sakta dhe fatkeqësisht, aktualisht nuk duket se ekziston ndonjë sistem llogaridhënieje.

Si kundërpeshë ndaj informacionit të rremë, “*halucinacioneve*” dhe *deepfake*-ve të prodhuara nga IA gjenerative, disa kanë propozuar që certifikimi i informacionit të saktë është një mjet thelbësor. Disa kanë sugjeruar një lloj *blockchain*-i ose regjistri që mund të gjurmojë dhe demonstrojë zinxhirin e ruajtjes së informacionit, në mënyrë që njerëzit ta dinë nga vjen ai dhe nëse është krijuar në mënyrë sintetike. Janë marrë në konsideratë edhe *watermarks* të vendosur mbi përmbajtjen, ndonëse disa grupe të lirisë së shprehjes i kundërshtojnë ato. Organi i standardeve quhet Koalicioni për Prejardhjen dhe Autenticitetin e Përmbajtjes (C2PA) dhe firma e nisma të ndryshme punojnë për zbatimin e këtyre standardeve.

C2PA u themelua në shkurt 2021 nga Adobe, Arm, BBC, Intel, Microsoft dhe Truepic. Themeluesit ngritën një projekt të Joint Development Foundation, me më shumë se 200 anëtarë, për të ndërtuar së bashku

një standard teknik të hapur, i cili u ofron botuesve, krijuesve dhe konsumatorëve mënyra fakultative dhe fleksibël për të kuptuar autenticitetin dhe prejardhjen e llojeve të ndryshme të medias. Nisma për Autenticitetin e Përmbajtjes (CAI - *Content Authenticity Initiative*), e udhëhequr nga Adobe, përfshin më shumë se 3 000 anëtarë, që punojnë për lehtësimin e zbatimit të standardit C2PA duke krijuar mjete me kod të hapur për këtë qëllim dhe duke shkëmbyer praktikat më të mira. Project Origin ishte një grup komunitar i ngjashëm me CAI-n, i themeluar nga Microsoft, New York Times dhe BBC, i përqendruar te zbatimi i C2PA-së në redaksi. Ai tani punon ngushtësisht me Këshillin Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve të Shtypit (IPTC) për të krijuar dhe menaxhuar një listë botuesish lajmesh të verifikuar, të pajtueshëm me C2PA-në, dhe ka publikuar një listë pjesëmarrësish në fazën e provës, ku përfshihen BBC dhe CBC/Radio Canada. Qëllimi i tyre është të rrisin autenticitetin dhe transparencën në përmbajtjen dixhitale përmes një standardi të hapur prejardhjeje. Truepic është një firmë e bazuar në SHBA, që punon me kompani si Qualcomm, Microsoft, Hugging Face e të tjera për zbatimin e standardeve C2PA. (Burimet: Santiago Lyon dhe Mounir Ibrahim)

III. Projektligje

Projektligjet janë të shumta dhe ndryshojnë nga rajoni në rajon e nga vendi në vend, por në SHBA (ku janë të vendosura shumë prej firmave të IA-së) deri më sot nuk ka pasur legjislacion. Shtetet federale kanë miratuar ligjet e tyre për IA-në dhe Zyra amerikane e Politikave për Shkencën dhe Teknologjinë ka botuar një projektkartë të drejtash për epokën e IA-së (*Blueprint for an AI Bill of Rights*), ndërsa ish-presidenti Joe Biden nxori një urdhër ekzekutiv. Bashkimi Europian ka miratuar një Akt të detajuar për IA-në, ndërsa Meksika, Kina, Brazili dhe Japonia kanë rregullore në hartim e sipër. Megjithatë, asnjëra prej këtyre rregulloreve nuk i trajton drejtpërdrejt çështjet në të cilat është përqendruar komuniteti gazetaresk.

Lloji	Bashkimi European	Shtetet e Bashkuara	Kina	Mbretëria e Bashkuar	Japonia
Qasja rregullatore	Ligj gjithëpërfshirës (Akti i IA-së) me qasje të bazuar në nivele rreziku dhe kërkesa strikte për sistemet e IA-së me rrezik të lartë.	Qasje e decentralizuar, me ligje sektoriale specifike dhe agjenci të ndryshme që nxjerrin udhëzime e parime.	Qasje e centralizuar, me kontroll të fortë qeveritar mbi zhvillimin dhe vendosjen e IA-së.	Qasje pro-inovacionit, fleksibël, që synon nxitjen e inovacionit duke siguruar njëkohësisht siguri dhe etikë.	Qasje e bazuar në rrezik dhe në “ligj të butë”, e quajtur “qeverisje e shkathët” (<i>agile governance</i>).
Udhëzimet etike	Një grup prej gjashtë parimesh etike për të nxitur IA të besueshme, siç janë veprimtaria dhe mbikëqyrja njerëzore, transparenca, diversiteti, mosdiskriminimi dhe drejtësia.	“Blueprint for an AI Bill of Rights” përqendrohet te drejtësia, transparenca dhe llogaridhënia, për të siguruar përdorim të përgjegjshëm të IA-së.	Udhëzimet etike theksojnë përputhjen me qëllimet kombëtare dhe stabilitetin shoqëror.	Qendra për Etikën dhe Inovacionin e të Dhënave (CDEI) publikon një manual drejt një ekosistemi efektiv të garantimit të IA-së.	“AI Utilization Guidelines” thekson përdorimin etik të IA-së dhe nxitjen e inovacionit.
Privatësia e të dhënave	Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) zbatohet për të gjitha industritë dhe të gjitha të dhënat personale, me kërkesa të forta.	Nuk ka ligj federal, por rregullore sektoriale dhe shtetërore, si Akti i Privatësisë së Konsumatorit i Kalifornisë.	Kërkesa strikte, me ligje të reja si Ligji për Mbrojtjen e Informacionit Personal dhe Ligji për Sigurinë e të Dhënave.	UK GDPR, i ngjashëm me GDPR-në e BE-së.	Akti për Mbrojtjen e Informacionit Personal (APPI) përfshin masa strikte lidhur me shkeljet e të dhënave.
Financimi	Financim i konsiderueshëm zhvillimi përmes programeve Horizon Europe dhe Digital Europe.	Investime publike përmes agjencive si NSF dhe DARPA, investime të mëdha të sektorit privat dhe grante kërkimore akademike.	Investime të konsiderueshme qeveritare, ndërmarrje shtetërore dhe investime private.	Strategjia Kombëtare e IA-së thekson financimin publik e privat. Financim qeveritar përmes <i>UK Research and Innovation</i> (UKRI).	Investime të konsiderueshme në IA përmes nismave qeveritare, si programi <i>Society 5.0</i> .

Tabela 1: Krahasimi i legjislacionit për IA-në në BE, Shtetet e Bashkuara, Kinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Japoni

Është Bashkimi European ai që po udhëheq, duke prezantuar një regjim rregullator që i balancon të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes me përgjegjësitë dhe udhëzimet. Në maj 2024, Këshilli i Europës ra dakord për një traktat mbi përdorimin e sistemeve të IA-së. Konventa, e cila është detyruese për 44 shtete, përfshin kërkesa për transparencë dhe mbikëqyrje dhe përcakton përgjegjësi për respektimin e së drejtës ndërkombëtare dhe të institucioneve demokratike.

Akti i BE-së për Lirinë e Medias përfshin një dispozitë në nenin 18, e cila kërkon që platformat shumë të mëdha online të përfshijnë një “funksionalitet” për prodhuesit e shërbimeve mediatike, me anë të të cilit këta të deklarojnë se nuk ofrojnë “përmbajtje të gjeneruar nga sistemet e inteligjencës artificiale pa e nënshtruar atë ndaj shqyrtimit njerëzor ose kontrollit editorial”.

Akti i BE-së për IA-në është bazuar në nivele rreziku, secili prej të cilëve kërkon kryerjen e veprimeve të ndryshme. Katër kategoritë janë: rrezik i papranueshëm, rrezik i lartë, rrezik i kufizuar dhe rrezik minimal. Fushat më të rrezikuara duhet të ofrojnë vlerësime rreziku dhe shpjegime se çfarë të dhënash janë përdorur. Rregullatorët janë të vetëdijshëm se aftësia e LLM-ve për të grumbulluar sasi të mëdha informacioni ka të ngjarë të ketë pasoja të rëndësishme për të drejtat e privatësisë dhe për kapacitetin shtetëror (ose të sektorit privat) për survejim, ndaj neni 5 përfshin kontrolle të rrepta për përdorimin e të dhënave biometrike.

Media nuk klasifikohet si sektor me rrezik të lartë, por gjithsesi do t'u nënshtrohet disa kërkesave për transparencë, si deklarimi kur përdoren *chatbot*-e. Edhe proceset e moderimit të përmbajtjes dhe algoritmet e rekomandimit u nënshtrohen kërkesave të transparencës.

Vendet e BE-së kanë dy vjet për t'i zbatuar rregulloret. “Efekti i Brukselit” (*The Brussels Effect*), termi i profesores Anu Bradford, përshkruan se si legjislacioni i BE-së vendos standarde edhe jashtë BE-së.

Udhëzimet e UNESCO-s mbi IA-në, qeverisjen dhe diversitetin

POLITIKA	DETAJET
Konventa e vitit 2005 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore	Bën thirrje për ruajtjen e diversitetit kulturor dhe njëh se kultura është pjesë kyçe e kohezionit shoqëror. Shqyrton disa nga pyetjet kryesore që mund të prekin shkencëtarët, artistët, edukatorët dhe gazetarët.
Rekomandimi i UNESCO-s i vitit 2021 mbi Etikën e Inteligjencës Artificiale	Mbrojtja e të drejtave dhe e dinjitetit të njeriut është themeli i Rekomandimit, i mbështetur në avancimin e parimeve themelore, si transparenca dhe drejtësia, duke kujtuar gjithnjë rëndësinë e mbikëqyrjes njerëzore të sistemeve të IA-së.
Udhëzimet e UNESCO-s të vitit 2023 për qeverisjen e platformave dixhitale	Përqendrohen te ruajtja e lirisë së shprehjes dhe e aksesit në informacion, duke promovuar transparencën e platformave, llogaridhënien, kujdesin e duhur dhe fuqizimin e përdoruesve mbi bazën e standardeve të të drejtave të njeriut.

IV. Shqetësimet për të drejtën e autorit

LLM-të trajnohen me sasi masive të dhënash, por deri më tani firmat e IA-së gjenerative kanë ngurruar t'i kompensojnë siç duhet krijuesit e këtyre të dhënave. Në SHBA, ato pretendojnë se nuk kanë nevojë ta bëjnë: sipas tyre, ky përdorim mbulohet nga përjashtimi i “përdorimit të drejtë” (*fair use*). Vende të tjera nuk e njohin konceptin e “*fair use*”, kështu që përdorimi i të dhënave të tyre nga LLM-të përbën shkelje flagrante. Rastet konkrete janë çështje ligjore dhe disa botues gazetash po e padisin OpenAI-n. Por, mbetet çështje politikash nëse ligji duhet ndryshuar për të sqaruar se ajo që po bëjnë nuk është përdorim i drejtë, pra, se krijuesit e të dhënave duhet të kompensohen.

Botues dhe shkrimtarë në shumë vende e kanë kundërshtuar shpërfilljen flagrante të së drejtës së autorit, të dëshmuar nga zvarritja pa dallim ose “përthithja” e të dhënave nga interneti. Më 6 prill 2024, New York Times raportoi se OpenAI kishte transkriptuar më shumë se një milion orë përmbajtjeje nga videot e YouTube dhe i kishte futur në ChatGPT-4.

Google ndryshoi gjithashtu kushtet e shërbimit, në mënyrë që të mund të përdorte përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit në dokumentet publike të Google dhe në recensionet e restoranteve. Meta diskutoi blerjen e shtëpisë botuese Simon & Schuster. Sipas The New York Times, punimi i vitit 2020 i fizikanit të

MIT-it, Jared Kaplan, argumentonte se masa është thelbësore për trajnimin e modeleve. Meqenëse LLM-të kanë nevojë për trilionat “tokens”, firmat e IA-së grumbullojnë vazhdimisht përmbajtje nga i gjithë web-i, duke i shpërfillur të drejtat e pronësisë intelektuale dhe përpjekjet e shpenzimit e jashtëzakonshme që kërkon krijimi i informacionit, një shembull klasik i “përfitimit pa kundërshtpërblim” (*free riding*).

Arsyeja kryesore pse botuesit anembanë botës shqetësohen për mbrojtjen e së drejtës së autorit është se përdorimi i pakompensuar i përmbajtjes së botuesve kërcënon qëndrueshmërinë e mediave. Në fakt, Parimet Globale të Shoqatës Botërore të Gazetave, të gushtit 2023, argumentojnë se “përvetësimi pa dallim i pronësisë sonë intelektuale [nga sistemet e IA-së] është joetik, i dëmshëm dhe shkelje e të drejtave tona të mbrojtura”.

Pritet që mjetet e reja të kërkimit me IA gjenerative t'i dëmtojnë të ardhurat e botuesve dhe të krijuesve edhe më shumë sesa brezi i mëparshëm i motorëve të kërkimit dhe mediave sociale. Ka pasur një përkeqësim të të ardhurave për mediat tradicionale, sepse platformat e kërkimit dhe të mediave sociale përvetësuan të ardhurat nga reklamat, të cilat më parë ndihmonin në financimin e gazetarisë. Megjithatë, këto platforma shpesh e identifikonin burimin e informacionit dhe mund të sillnin njëfarë trafiku drejt mediave tradicionale. Por, me IA-në/LLM-të mund të mos ketë fare atribum, dhe gjasat për të shkuar te burimi origjinal mund të jenë edhe më të ulëta, çka sjell pasoja edhe më të mëdha për ekosistemin e informacionit.

Avokuesit po u bëjnë thirrje vendeve që kanë sisteme kompensimi për botuesit që t'i përditësojnë ato, në mënyrë që të përfshihen edhe firmat e IA-së gjenerative që po përdorin përmbajtje pa paguar. Ata po kërkojnë gjithashtu dispozita “*must-carry*”, në mënyrë që firmat e IA-së gjenerative që nuk duan të paguajnë të mos përgjigjen duke i hequr lajmet, siç ka bërë Meta në Kanada.

Vlerësimi i përmbajtjes

Nuk ka një standard global se si duhet vlerësuar përmbajtja, çka sugjeron se ndoshta UNESCO mund të organizonte një takim për të diskutuar ekonominë e vlerësimit të përmbajtjes. Mike Cragg, ekonomist i specializuar në procese gjyqësore, i cili punon për praktikën e konsulencës teknologjike të Keystone, vëren se “të dhënat e përdorura për trajnimin e një modeli bazë LLM ekzistues, përimtësimi (*fine-tuning*) i një modeli të tillë, apo trajnimi për një aplikim specifik me një model gjenerimi të shtuar me kërkim (*Retrieval Augmented Generation* - RAG), për aplikime në kohë reale ose të specializuara, do të kenë vlera të ndryshme në varësi të aplikimit”. Por, ndonëse mund të ketë mospajtime për vlerën e saktë, duket qartë se vlera është pozitive dhe, në disa raste, e madhe. E njëjta gjë vlen edhe për dëmet e mundshme ndaj ekosistemit të informacionit.

Gjenerimi i Shtuar me Kërkim (RAG)

Gjenerimi i Shtuar me Kërkim (*Retrieval Augmented Generation* — RAG) i kombinon qasjet e bazuara në kërkim me ato të bazuara në gjenerim, për të përmirësuar aftësinë e IA-së për të dhënë përgjigje të sakta dhe të përshtatshme për kontekstin. Sistemet RAG marrin dokumente ose pjesë informacioni relevante nga një bazë e madhe të dhënash dhe e përdorin këtë informacion për të gjeneruar rezultate më të informuara e më precize. Kjo qasje e rrit cilësinë e përgjigjeve të gjeneruara duke i mbështetur ato në të dhëna reale.

Një çështje kyçe në përcaktimin se sa duhet t'i takojë secilit botues/krijues është vërtetimi se nga vijnë të dhënat që përdoren. Media në Europë dhe në SHBA po nënshkruajnë marrëveshje licencimi për përmbajtjen e tyre me OpenAI, Perplexity dhe kompani të tjera. Po kryhen disa pagesa në para, por po

jepen edhe të drejta për të përdorur mjetet dhe tokens dhe mundësi për të projektuar produkte të reja, si mjetet e kërkimit.

Botuesit e lajmeve kishin shpresuar për atribuim dhe lidhje drejt përmbajtjes së tyre, por nuk është e qartë se si do të zhvillohet teknologjia. Kanë dalë raportime se Perplexity dhe OpenAI nuk arrijnë t'i citojnë dhe t'i lidhin në mënyrë të qëndrueshme burimet e tyre.

Një pikë mos pajtimi është nëse pagesat nga firmat e mëdha të IA-së duhet t'i marrin botuesit apo krijuesit. Në Brazil, muzikantët kanë kërkuar një pjesë të honorarëve. Në Belgjikë, direktivat europiane të së drejtës së autorit kërkojnë që krijuesit të paguhen, ndërsa negociatat e botuesve me Google jo. Botuesit janë të bindur se, meqenëse janë ata që mbartin kostot dhe rreziqet, pagesat duhet t'u shkojnë atyre. Le Monde nënshkroi një marrëveshje me OpenAI, në vitin 2024, dhe, pas marrëveshjes, si dhe për të përmbushur legjislacionin e të drejtave fqinje, media franceze vendosi t'ua shpërndajë gazetarëve të saj 25% të të ardhurave lidhur me produktin. Gazetarët duhet të mësojnë nga industri të tjera, si muzika, ku si artistët, ashtu edhe botuesit e tyre kanë arritur marrëveshje.

Botuesit po përpiqen gjithashtu të kuptojnë se cila përmbajtje është e dobishme dhe si ta përshtatin përmbajtjen e tyre sipas kërkesave të reja dhe një bote në të cilën kërkohen të dhëna të bazuara (domethënë të dhëna që bazohen në informacion që është verifikuar) dhe informacion i verifikuar i azhurnuar. Për shembull, marrëveshja e Axel Springer-it me OpenAI nuk ka të bëjë vetëm me shitjen e të drejtave për përdorimin e arkivit të Axel Springer-it, por do të kërkojë që Axel Springer të ofrojë përmbledhje, të bazuara në përmbajtjen e botimeve të veta, në përgjigje të kërkesave në ChatGPT.

V. Gazetarët: Koha për të përditësuar rregullat e “*fair use*” në tregjet kryesore ku janë të vendosura kompanitë e IA-së

Ndërsa kompanitë e IA-së pretendojnë se përdorimi që ato u bëjnë fjalëve apo *tokens* përfshihet plotësisht brenda doktrinë së përdorimit të drejtë, krijuesit dhe botuesit argumentojnë se ligjet e së drejtës së autorit duhen përditësuar, ose të paktën zbatuar siç duhet, në dritën e shfaqjes së sistemeve të IA-së. Doktrina e “*fair use*” është krijim amerikan dhe u hartua përpara se të ekzistonte IA gjenerative. Ajo nuk është menduar për t'u marrë me LLM-të dhe me agjentët e bazuar në web, që përpijnë sasi të mëdha të dhënash - ta zemë nga një gazetë - dhe pastaj ripërpunojnë diçka që i ndërlidh ato të dhëna në mënyra që nuk janë transparente në lidhje me atë që ka mbledhur intelijenca artificiale. Ka pasur raste kur modelet e IA-së kanë nxjerrë tekste të tëra, me ose pa atribuim, si dhe tekste të tëra me atribime të pasakta. Shembuj të një plagjiature të tillë janë dokumentuar mirë nga shkrimtarë e artistë, si dhe në disa nga paditë gjyqësore si padia e The New York Times kundër OpenAI-t.

Rregulloret e së drejtës së autorit - Gazetaria e prekur nga mungesa e marrëveshjes globale për pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e së drejtës së autorit për të dhënat hyrëse (input data)

SHBA	"Fair Use" (përdorimi i drejtë) është koncept, i cili nuk ekziston saktësisht në të njëjtën formë askund tjetër në botë.
Japonia	Rregulloret në hartim nuk japin asnjë mbrojtje të së drejtës së autorit për të dhënat hyrëse në LLM-të.
Kina	Projektligji kinez për IA-në ofron mbrojtje të kufizuar të së drejtës së autorit për të dhënat hyrëse në LLM-të. Neni 21 e lejon përdorimin e materialeve me të drejta autori për trajnimin e modeleve të IA-së, me kusht që përdorimi të jetë i justifikuar dhe t'i respektojë të drejtat e krijuesve origjinalë. Megjithatë, ligji përqendrohet kryesisht te mbrojtja e përmbajtjes së gjeneruar nga IA dhe përcakton udhëzime të hollësishme për njohjen e përmbajtjes së tillë sipas së drejtës së autorit ose të patentave, bazuar në kontributin e përdoruesit.
Europa	Vendet e Bashkimit Europian nuk i kanë zbatuar direktivat e BE-së për të drejtën e autorit në mënyrë të njëtrajtshme. Mbeten dallime kombëtare.
Mbretëria e Bashkuar	Ligji aktual nuk ofron mbrojtje eksplicite të së drejtës së autorit për të dhënat e përdorura për trajnimin e LLM-ve.

Tabela 2: Rregulloret e së drejtës së autorit në Shtetet e Bashkuara, Kinë, Japoni, Europë dhe Mbretërinë e Bashkuar

Udhëzime të ndryshme të publikuara

Një numër organizatash mediatike, përfshirë Këshillat e Shtypit të BE-së, kanë publikuar udhëzime etike ose kanë shtuar mbi ato ekzistuese. Një pikë e theksuar vazhdimisht është rëndësia e transparencës dhe e mbikëqyrjes njerëzore. Kështu, Shoqata Botërore e Gazetave publikoi Parimet Globale për Inteligjencën Artificiale në shtator 2023. Ndër të tjera, parimet u bëjnë thirrje zhvilluesve, operatorëve dhe vendosësve të IA-së që:

- T'i respektojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, që mbrojnë investimin e organizatave në përmbajtjet origjinale.
- Të shfrytëzojnë modele efikase licencimi, që mund ta lehtësojnë inovacionin përmes trajnimit të sistemeve të IA-së të besueshme dhe me cilësi të lartë.
- Të ofrojnë transparencë të hollësishme, që t'u mundësojë botuesve zbatimin e të drejtave të tyre kur përmbajtja e tyre përfshihet në grupet e të dhënave të trajnimit.
- Ta atribuojnë qartë përmbajtjen te botuesit e saj origjinalë.
- Ta njohin rolin e botuesve në gjenerimin e përmbajtjes me cilësi të lartë për trajnim.
- Të mos i keqparaqesin veprat origjinale.
- Ta respektojnë privatësinë e përdoruesve që ndërveprojnë me ta dhe ta deklarojnë plotësisht përdorimin e të dhënave të tyre personale në dizajnimin, trajnimin dhe përdorimin e sistemit të IA-së.

Në korrik 2023, studiues të medias, gazetarë dhe botues nga e gjithë bota u mbledhën në Afrikën e Jugut për të hartuar dokumentin *"Big Tech dhe Gazetaria: Parimet për Kompensim të Drejtë"*. Këto parime u bënin thirrje platformave të jenë transparente dhe të drejta për pagesat e tyre ndaj mediave dhe të mbështesin një pluralitet mediash dhe diversitet pikëpamjesh.

Aspekti/Organizata	Reporterët pa Kufij (RSF)	Forumi Ekonomik Botëror (WEF)	Shoqata Botërore e Gazetave dhe Botuesve të Lajmeve (WAN-IFRA)	Koalicioni i 17 Organizatave të Lajmeve, përfshirë ICIJ
Politika	IA dhe e Drejta për Informacion	Rekomandimet e Presidios për IA-në Gjenerative të Përgjegjshme	Parimet Globale për IA-në	Karta e Parisit për IA-në dhe Gazetarinë
Rregullorja	Avokon rregullore strikte për të parandaluar dëmet ndaj së drejtës për informacion të besueshëm	Bën thirrje për një nismë globale të qeverisjes së IA-së	Avokon vetërregullimin, me standarde dhe udhëzime etike në shkallë industrie	Bën thirrje për transparencë, llogaridhënie dhe vendimmarrje etike
Kompensimi	E drejta për të hequr dorë (<i>opt-out</i>) nga trajnimi i LLM-ve; kompensim i drejtë për përdorimin e përmbajtjes, përmes shpërndarjes së pavarur e transparente	Bën thirrje për përditësimin e ligjeve të së drejtës së autorit, për të mundësuar atribuimin e duhur dhe ripërdorimin etik e ligjor të përmbajtjes ekzistuese	Thekson të drejtat e pronësisë intelektuale dhe shpërblimin e përshtatshëm për botuesit për përdorimin e pronësisë së tyre intelektuale	Kërkon që pronarët e sistemeve të IA-së t'i citojnë burimet, ta respektojnë pronësinë intelektuale dhe të sigurojnë kompensim të drejtë për gazetarët
Dezinformimi	Bën thirrje për një regjim të qartë llogaridhënieje, me sanksione penale kundër <i>deepfake</i> -ve të dëmshme	Promovon <i>feedback</i> -un e përdoruesve, deklarimin e ndërveprimit jonjerëzor dhe gjurmueshmërinë e përmbajtjes	Promovon llogaridhënien për rezultatet e sistemeve, përfshirë përmes regjimeve të kufizuara të përgjegjësisë dhe “porteve të sigurta”	Thekson veprimtarinë njerëzore në vendimet editoriale dhe transparencën në përmbajtjen e gjeneruar nga IA
Implikimet shoqërore	Nënvizon nevojën për ta mbrojtur rolin e gazetarisë dhe për ta penguar IA-në t'i minojë vlerat demokratike	Synon ta balancojë inovacionin e IA-së me konsideratat etike, për të rritur përfitimin shoqëror	Thekson rolin e botuesve në gjenerimin e përmbajtjes me cilësi të lartë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë	Thekson përdorimin etik të IA-së për të mbrojtur të drejtat e njeriut, paqen, demokracinë dhe diversitetin

Tabela 3: Rekomandimet e shoqërisë civile dhe të gazetarisë

Në fokus: gjuhët e vogla

Deklarata “Windhoek + 30” për Informacionin si e Mirë Publike, e vitit 2021, e riafirmoi rëndësinë e informacionit si një e mirë publike, si dhe rëndësinë e pluralizmit dhe të diversitetit. Megjithatë, mediat më të vogla nuk do të mund të fitojnë para nga IA gjenerative, ndërsa gjuhët më të vogla shqetësohen se mund të jenë në rrezik. LLM-të trajnohen me sasi të mëdha të dhënash — sa më e madhe sasia e të dhënave, aq më mirë performojnë ato. Por kjo mund t'i vërë në dezavantazh shoqëritë e vogla. A do ta përshpejtojnë LLM-të procesin me të cilin anglishtja është bërë gjuha mbizotëruese? Nëse po, çfarë mund të bëhet për ta ruajtur diversitetin kulturor?

Si shembull, Qeveria e Islandës vendosi se opsioni më i mirë është t'i japë OpenAI-t shumë përmbajtje islandeze, që ajo të përdoret në modelet e tyre, për t'i bërë ato më të sakta dhe më cilësore. Qeveria ndau 4 miliardë korona islandeze dhe kompania gjuhësore Miðeind ka krijuar mjete të kontrollit drejtshkrimor dhe gramatikor në islandisht.

“Në shumë komunitete gjuhësh me burime të pakta, njerëzit e kuptojnë dhe e pranojnë se gjuhët tona nuk do të përfaqësohen në mënyrë të përshtatshme në modelet gjuhësore më të përparuara, nëse ne nuk jemi të gatshëm t'i japim të dhënat tona për trajnimin e tyre. Shumë veta janë të mendimit se ruajtja e gjuhës duhet të ketë përparësi ndaj konsideratave të së drejtës së autorit.”

Linda Heimisdóttir, drejtore ekzekutive e kompanisë gjuhësore islandeze Miðeind

Shembuj të tjerë: krijimi i modeleve të vogla gjuhësore për arkivim dhe dokumentim nga një organizatë jofitimprurëse në Zelandën e Re, ku Te Hiku Media zhvilloi modele gjuhësore të trajnuara me IA, për të ndihmuar në parandalimin e rënies së mëtejshme të gjuhës Te Reo Māori (burimi: “How AI is helping revitalise indigenous languages”). Ai Pirinka, e krijuar me një akademik japonez, po përdoret për ta ruajtur gjuhën unike të popullit Ainu, banorëve autoktonë të Hokaidos, në Japoninë verilindore. Woolaroo, i financuar nga Google (një partneritet me UNESCO-n), e përdor mësimin makinerik për të mësuar dhe ruajtur gjuhë si jidishtja dhe kreolishtja e Luizianës, si dhe për të shfaqur folës të gjuhëve të rrezikuara dhe mënyrën e shqiptimit të tyre.

REKOMANDIMET

Rekomandime për kompanitë e IA-së

Qeverisje e bazuar në të drejtat e njeriut - Në çdo lloj rregullimi, kompanitë e IA-së duhet të jenë në gjendje të tregojnë sistemet ose proceset që kanë ngritur për të siguruar kujdesin e vazhdueshëm të duhur ndaj të drejtave të njeriut, si dhe masat për zbutjen e rreziqeve. Këto sisteme duhet të rishikohen periodikisht dhe rishikimi duhet të bëhet publik.

Qëndrueshmëria dhe diversiteti i mediave – Kompanitë e IA-së gjenerative duhet të krijojnë korniza dhe standarde transparente për bashkëpunimin me botuesit dhe krijuesit, me fokus te diversiteti dhe gjithëpërfshirja (duke përfshirë bashkëpunimin përtej mediave mbizotëruese anglishtfolëse). Ato duhet të bashkëpunojnë aktivisht dhe të kërkojnë kontributet e gazetarëve, të botuesve dhe të mediave, për të përmirësuar veçoritë ekzistuese dhe për të zhvilluar produkte të reja që mbështesin përmbajtjen gazetareske cilësore dhe pluraliste.

Transparenca – Kompanitë e IA-së gjenerative duhet t'i raportojnë rregullisht publikut dhe sistemit të qeverisjes se si u përmbahen parimeve të transparencës. Kjo përfshin transparencën lidhur me praktikatat e mbledhjes së të dhënave dhe të nxjerrjes së të dhënave nga webi (*web scraping*).

Nxjerrja e të dhënave nga webi (*web scraping*) – Kompanitë e IA-së gjenerative që përdorin robotë kërkimi (*web crawlers*) dhe teknika të tjera për mbledhjen e të dhënave jopersonale të disponueshme publikisht, duhet t'u ofrojnë faqeve të internetit dhe pronarëve të përmbajtjes mjete efektive për të parandaluar nxjerrjen e padëshiruar të automatizuar të të dhënave (pjesërisht ose tërësisht).

Atribuiimi – Kompanitë e IA-së gjenerative duhet të përqendrohen urgjentisht në përmirësimin e mekanizmave të atribuiimit dhe t'u mundësojnë përdoruesve të identifikojnë dhe të lidhen me gazetarët, burimet mediatike dhe botuesit duke e cituar dhe lidhur përmbajtjen e tyre saktësisht dhe sistematikisht.

Prejardhja - Kompanitë e IA-së gjenerative duhet të zhvillojnë mekanizma efektivë zbutës për t'i trajtuar rreziqet e përhapjes së informacionit mashtrues dhe të halucinacioneve. Ato duhet të mbështesin gjithashtu përpjekjet për certifikimin e informacionit të saktë dhe të prejardhjes së tij (burimi dhe historiku) dhe të shqyrtojnë mekanizma për të nxjerrë në pah dhe promovuar përmbajtje mediatike të certifikuar, me cilësi të lartë.

Të integrojnë vlerësime të rregullta ndikimi për produktet dhe shërbimet ekzistuese e të reja, veçanërisht kur këto prekin mediat, sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e shprehjes në përgjithësi, si dhe privatësinë e audiencave.

Ta respektojnë pronësinë intelektuale duke kërkuar leje përpara përdorimit të përmbajtjes me të drejta autori për trajnim dhe duke paguar për përdorimin e asaj përmbajtjeje, sipas marrëveshjes dhe negocimit të ndërsjellë ndërmjet palëve.

Së paku, t'i respektojnë vendimet e vetëpërkrahimit (*opting-out*), robots.txt dhe programet e tjera të krijuara për ta bllokuar *web crawling*. Të shqyrtohet projektimi i sistemit mbi bazën e pëlqimit paraprak (*opting-in*).

Të krijojnë korniza dhe standarde transparente për pagesat ndaj botuesve/krijuesve dhe t'i bëjnë publike marrëveshjet e licencimit të IA-së.

Të jenë transparente se nga vjen përmbajtja dhe çfarë të dhënash janë përdorur në trajnim, duke e kryer këtë në vijimësi

Të ofrojnë citime, t'i deklarojnë të dhënat hyrëse dhe t'i citojnë burimet e informacionit.

Aty ku ka korniza të ndryshme legjislative të miratuara anembanë botës, t'i zbatojnë ligjet në mënyrë të njëtrajtshme ndërmjet juridiksioneve, duke zgjedhur ato që i mbështesin më shumë të drejtat e njeriut.

Për të qenë sa më i lirë nga paragjykimet dhe dezinformimi, duke respektuar privatësinë dhe promovimin e lirisë së shprehjes.

Rekomandime për botuesit/redaksitë

Të miratojnë politika të qarta, ose t'i përditësojnë ato ekzistuese, për përdorimin e IA-së gjenerative dhe t'ua komunikojnë ato audiencave. Të kërkojnë mbikëqyrje dhe përfshirje njerëzore në të gjitha nivelet e procesit.

Së paku, përdorimi i IA-së gjenerative për raportim dhe analizë të dhënash duhet të etiketohet qartë dhe t'u deklarohet audiencave. Në të njëjtën mënyrë, edhe rezultatet e gjeneruara artificialisht, përfshirë imazhet dhe audion, duhet të etiketohen si të tilla.

Meqenëse media ka fuqinë ta ndikojë ndjeshëm debatin publik dhe ta formësojë diskutimin, gazetaria duhet të shtrojë pyetje kyçe, si: si mund të punojë IA për shoqërinë dhe si duhet të punojë ajo, dhe si zbatohet ajo jo vetëm në sferën e drejtpërdrejtë të gazetarisë, por edhe në sektorë të tjerë të shoqërisë.

Ta mbrojnë privatësinë e audiencave. Çdo përdorim i të dhënave të personalizuara duhet t'i respektojë ligjet e privatësisë dhe, në rajonet ku ligje të tilla nuk ekzistojnë, mediat duhet të ndjekin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Të marrin pjesë në hartimin e politikave të Edukimit për Median dhe Informacionin.

Rekomandime për shtetet

Qeveritë mund të përpiqen, përmes proceseve rregullatore, ta parandalojnë kontrollin e mjeteve të IA-së nga vetëm pak subjekte dhe të sigurojnë që zhvillimi dhe vendosja e tyre t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë mbrojtjen e privatësisë, të drejtave të pronësisë intelektuale, të drejtave të punës dhe lirisë së shprehjes.

Autoritetet rregullatore duhet të jenë gjithashtu të kujdesshme, sepse kufizimet e gjera mbi përmbajtjen e gjeneruar nga IA mund të përfundojnë duke krijuar kufizime më të mëdha të lirisë së shprehjes.

Sistemet e qeverisjes së IA-së duhet ta promovojnë dialogun me mediat, përfshirë për investimin në media të pavarura, dhe ta mbështesin ekosistemin mediatik duke i vënë të dhënat në dispozicion dhe duke mbështetur veprime që e forcojnë qëndrueshmërinë, diversitetin dhe pluralizmin e mediave.

Qeveritë duhet ta promovojnë Edukimin për Median dhe Informacionin, për të nxitur angazhimin pozitiv me platformat e IA-së gjenerative, me synimin e fuqizimit të përdoruesve, në veçanti të grupeve në situata vulnerabël dhe marginalizimi.

Në përputhje me udhëzimet e UNESCO-s, rregullimi i IA-së duhet të hartohet në mënyrë të tillë që t'i ruajë të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes, si dhe pluralitetin e zërave.

Të rregullojnë për të siguruar që tregjet të mbeten konkurruese, ndërkohë që respektohen të drejtat e njeriut, që krijuesit të kreditohen dhe që burimet të etiketohen qartë.

Rekomandime për organizatat ndërqeveritare

UNESCO mund të thërrasë takime shumëpalëshe për t'i diskutuar standardet e vlerësimit të përmbajtjes dhe të drejtat e organizatave të gazetarisë e të krijuesve të përmbajtjes.

UNESCO ka rekomanduar që qeveritë ta promovojnë Edukimin për Median dhe Informacionin.

UNESCO mbështet gjithashtu një qasje gjithëpërfshirëse për mbështetjen e qëndrueshmërisë së mediave, përfshirë mbështetjen financiare për lajmet me interes publik, me kushtin që të respektohet pavarësia editoriale.

PËRFUNDIM

Në kohën kur është shkruar ky material, dukej se e ardhmja e gazetarisë, si dhe e shumë fushave të tjera të lidhura me kulturën, arsimin e më gjerë, do të përmbysesh. Pyetjet janë të pafundme dhe ende pa përgjigje. Ritmi i ndryshimit duket i jashtëzakonshëm dhe komuniteti i gazetarisë, gjithnjë i gatshëm për inovacion dhe për t'u përshtatur, po bëhet gati për edhe një transformim tjetër.

Ndërsa mendojmë se si të lundrojmë në një botë ndoshta të re, është e rëndësishme të mos biem në grackën e të menduarit se rregullimi qeveritar do ta mbysë inovacionin dhe, për rrjedhojë, nuk duhet ndjekur. Inovacioni nuk është qëllim në vetvete: ka inovacione që e rrisin fuqinë në treg dhe shfrytëzimin. Inovacioni duhet të orientohet drejt rritjes së mirëqenies shoqërore.

Ky punim ka identifikuar një numër kërcënimesh që IA i paraqet gazetarisë dhe, të paktën në disa raste, korniza rregullatore premtuese që i zbusin sadopak këto kërcënime. Siç shprehet Guy Berger, ish-drejtori

i politikave dhe strategjisë në UNESCO: “Makinat mund të ishin më të lira pa rripa sigurimi dhe pa airbag-ë, por klientët përgjithësisht do të preferonin ato që i kanë zhvilluar dhe instaluar këto pajisje, edhe kur ato nuk kërkohen nga rregulloret.”

Zhvillimi i IA-së gjenerative dhe i teknologjisë së IA-së është ende në shfaqje e sipër. Përfaqësuesit e industrisë shpesh argumentojnë se bëhet fjalë për një industri të re dhe, për rrjedhojë, duart e saj nuk duhen lidhur shumë shpejt: “më mirë të shihet si ecin punët dhe, nëse shfaqet ndonjë problem, ai të trajtohet kur të jetë shfaqur dhe identifikuar qartë”. Ne kemi argumentuar se kjo perspektivë është e gabuar dhe e rrezikshme. Është e vështirë të zhbëhen monopolet dhe fuqia monopoliste pasi janë vendosur; është më mirë të parandalohet shfaqja e tyre. Në të vërtetë, rregullatorët e BE-së e theksojnë nevojën që qeveria të jetë në gjendje të rregullojë përpara se firmat të bëhen tepër të mëdha për t'u rregulluar. Kemi argumentuar, në përputhje me këtë, se është e rëndësishme që duart e qeverisë të mos lidhen shumë herët. Kërkohen monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm, dhe koha për të rregulluar është tani.